- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprejë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes

së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 **"Force Madhore"** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Paguesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni, Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 11,951.90 € (kjo siguri vlenë nga data e nënshkrimit të kontratës deri më 05.02.2021)
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>

Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 3 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
	12.3	Programi do të dorëzohet menaxherit të projektit
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 3 dite pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë sipas planit dinamik e që është 30 ditë
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vendpunishite nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet nga ZKA brenda tre dite nga data e nënshkrimit të kontratës
Pagesat	24.1	Pagesa do të bëhet sipas raportit të menaxherit të projektit
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 365 ditë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega Podujeve në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të

		<p>dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
--	--	--

PARAMASAT E RRETHOJAVE TE SHKOLLAVE

1. Rrethoja ne shkollen "Fan S.Noli"-Podujeve

Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	ç.mësi	Shuma
1	Piketimi i perimetrit ne te cilën do te rrethohet parcela.	m'			
2	Gërmimi në tokë të kategorisë së IV-të dhe V-të për vendosjen e themeleve masive me dim. 1*0.5M Në llogari hyrje edhe rrafshimi i terrenit	m³	100.00	0.60	60.00
3	Furnizimi me material dhe vendosja e zhavorit Fr 0-60 mm. Trashësia e shtreses se zhavorit duhet te jetë 10 cm. Në pozicion te përshkruhet edhe ngjeshja e zhavorit të vendosur.	m³	4.00	4.50	18.00
4	Furnizimi me material dhe vendosja e zhavorit Fr 0-31.5 mm. Trashësia e shtreses se zhavorit duhet te jetë 10 cm. Në pozicion te përshkruhet edhe ngjeshja e zhavorit të vendosur.	m³	2.00	4.50	9.00
5	Betonimi i themeleve dhe cokllës së me beton MB 30, duke patur kujdes që të bëhet ankerimi i shtyllave metalike 60 x 60 x 3 mm të cilat futen në masë betoni min.50 cm.	m³	8.00	47.00	376.00
6	Furnizimi ,prerja lakimi dhe montimi i armaturës sipas detalit të paraqitur nga mbikqytresi.	kg	800.00	0.47	376.00
7	Montimi i shtyllave metalike me dim. 60 x 60 x 3 mm me gjatësi 1.50m' të vendosura në çdo L=2.06 m'	copë	11.00	5.00	55.00
8	Montimi i profileve metalike horizontale me dim. 40 x 40 x 2 mm me gjatësi 2.00 m' të vendosura në L=1.00m'	m'	280.00	2.20	616.00
9	Montimi i profileve metalike vertikale me dim. 20 x 20 x 1.5 mm me gjatësi 1 m' të vendosura në çdo L=10 cm	m'	400.00	0.80	320.00
10	Mbyllja e shtyllave metalike nga sipër me dim. 60 x 60 x 3 mm	copë	11.00	0.10	1.10
11	Mbyllja e shtyllave metalike nga sipër me dim. 20 x 20x2 mm	copë	200.00	0.07	14.00
12	Ngjyrosja e tërësishtme e rrethojës me dy lvrje: minimum dhe dy lvrje ngjyrë	m'	360.00	1.50	540.00
Gjithsej:					2,385.10
tvsb 18					429.32
Totali					2,814.42

2. Rrethoja ne shkolles "Aleksander Xhuvani"-Podujeve

Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	ç.mësi	Shuma
1	Ankerimi i shtyllave metalike me profile rrethore h= 3 m	copë	24.00	9.00	216.00
2	Montimi i profileve metalike -rrjeta diagonale identike me atë ekzistuese	m'	48.00	5.80	278.40
3	Montimi i profileve metalike vertikale.	m'	480.00	0.80	384.00
4	Furnizimi dhe montimi i derës njëkahore me rrota rreshtitëse të vendosura mbi kanal in rreshtitës (të vendosura paraprakisht në bazën e betonit dhe që duhet të ketë dyfishin e gjatësisë së derës L= 9 m) dera e hyrjes duhet të jetë me gjatësi b=4.5 m dhe lartësi të njëjtë me rrethojën. Dera duhet të fiksohet në shtyllat e rrethojës, me të gjitha elementet e tjera përcjellëse që parashihen për dyer : dorezën, cilindrat, qelësat, përfocues , shtangues të derës në tokë. Dy shtylla metalike në të cilat perforohet dera duhet të kenë dimensione: 100*60*3mm dhe e njëjta me lartësi të rrethojës të funduara në themelin e betonit h = 50 cm. Korniza e tabeles/ ramit në të katër anët të jetë (40*40*3mm) si dhe shufrat vertikale të vendosen çdo 10 cm (20*20*2 mm) të salduara në kornizën e tabeles metalike.	copë	2.00	190.00	380.00
5	Punimi i derës hyrje me dim. 1.1 x 1.5 m' me konstrukcion metalik me të gjitha elementet/përcjellëse : me kornizë 40x 40 x 3 mm, paneli 20 x 20 x 2 mm	copë	2.00	50.00	100.00
6	Ngjyrosja e tërësishtme e rrethojës me dy lvrje : minimum dhe dy lvrje me ngjyrë	m'	660.00	1.50	990.00
Gjithsej:					2,348.40
tvsb 18%					422.71
Totali					2,771.11

3. Rrethoja ne shkollen "Shefki Kuleta"-Bellopojë

Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	ç.mësi	Shuma
1					

Paketimi i perimetrit ne te cilen do te rrethohet parcela.

Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	c.njës.	Shuma
2	Punimi i situacionit dhe profilit gjatësor të rrethojës pas perfundimit te punimeve (Situacioni dhe profili gjatësor duhet te punohet pas ekzekutimit te plotë te punëve dhe te hazohet ne matje gjeoderike te sakta ne teren.) Projekti i realizimit	m	330.00	0.10	33.00
3	Pastrimi fitosanitar I tërë perimetrit te rrethojës (Pastrimi fitosanitar përfshinë prerjen e shkurreve, barishteve dhe kositjen e barit. Në këtë pozicion duhet të përfshihet edhe krasitja e drunjve dhe prerja e drunjeve te thatë.)	m	330.00	0.25	82.50
4	Mbetjet nga pastrimi fitosanitarë nuk lejohet te dëjgen ato duhet te barten ne deponi .	m	330.00	0.20	66.00
5	Gërmimi në tokë të kategorisë së IV-të dhe V-të për vendosjen e themeleve të veçuara me dim. 50x50x80 cmxcmxcm Në flogari hynë edhe rrafshimi i terrenit.	Paushall	1.00	50.00	50.00
6	Furnizimi me material dhe vendosja e zhavorit Fr 0-60 mm. Trashësia e shtreses së zhavorit duhet te jetë 10 cm. Në pozicion te përfshihet edhe ngjeshja e zhavorit të vendosur.	m³	31.20	2.00	62.40
7	Furnizimi me material dhe vendosja e zhavorit Fr 0-31.5 mm. Trashësia e shtreses së zhavorit duhet te jetë 10 cm. Në pozicion te përfshihet edhe ngjeshja e zhavorit të vendosur.	m³	3.90	4.50	17.55
8	Betonimi i themeleve me dim.50x50x80 cmxcmxcm me beton MB 30, duke patur kujdes që të bëhet ankerimi i shtyllave metalike 60 x 60 x 3 mm të cilat futen në masë betoni min.50 cm,në flogari hyn edhe armimi sipas detalit të paraqitur nga or mbikq.	m³	3.90	4.50	17.55
9	Montimi i shtyllave metalike me dim. 60 x 60 x 3 mm me gjatësi 2.00 m' të vendosura në çdo L=2.06 m'	m²	23.40	45.00	1,053.00
10	Montimi i profileve metalike horiz.me dim. 40 x 40 x 2 mm me gjatësi 2.00 m' të vendosura në L=1.00 m'	copë	156.00	6.30	982.80
11	Montimi i profileve metalike vertikale me dim. 20 x 20 x 2 mm me gjatësi 1.50 m' të vendosura në çdo L=10 cm	m'	660.00	2.30	1,518.00
12	Furnizimi dhe montimi i derës rrethore me rrota rreshtitëse te vendosura mbi kanal rreshtitës (të vendosura paraprakisht ne bazën e betonit dhe që duhet te ketë dyfishin e gjatësisë së derës L= 9 m) dera e hyrjes duhet te jetë me gjatësi b=4.5 m dhe lartësi të njëjtë me rrethojën. Dera duhet te fiksohet ne shtyllat e rrethojës, me të gjitha elementet e tjera përcjelle që parashihen per dyer : dorezën, cilindrat, qelësat, përforcues , shtlangues te derës në tokë. Dy shtylla metalike ne te cilat perforcohet dera duhet te kenë dimensione: 100*60*3mm dhe e njëjte me lartësi te rrethojës te fonduara ne themelin e betonit h = 50 cm. Korniza e tabelës/ramit ne te kater anet te jetë (40*40*3mm) si dhe shufrat vertikale te vendosen çdo 10 cm (20*20*2 mm) te salduara ne kornizen e tabelës metalike .	copë	2.00	190.00	380.00
13	Punimi i dorës hyrëse me dim. 1,1 x 1,5 m' me konstrukcion metalik me te gjitha elementet/percjellese : me kornizë 40x 40 x 3 mm, paneli 20 x 20 x 2 mm	copë	2.00	190.00	380.00
14	Mbyllja e shtyllave metalike nga sipër me dim. 60 x 60 x 3mm	copë	1.00	50.00	50.00
15	Mbyllja e shtyllave metalike nga sipër me dim. 20 x 20x2 mm	copë	156.00	0.10	15.60
16	Ngjyrosja e tërësisë me rrethojës me dy lverje : minimum dhe dy lverje me ngjyrit	m²	330.00	1.50	495.00
				Gjithsej:	9,014.40
				tvsh 18%	1,622.59
				Totali	10,636.99

4. Rrethoja ne shkollën "Ezrem Çabej"-Buricë

Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	c.njës.	Shuma
1	Piketimi i perimetrit ne te cilen do te rrethohet parcela.	m			
2	Montimi i shtyllave metalike me dim. 60 x 60 x 3 mm me gjatësi 1,50m' të vendosura në çdo L=2.06 m'	copë	13.00	5.00	65.00
3	Montimi i profileve metalike horiz.me dim. 40 x 40 x 2 mm me gjatësi 2.00 m' të vendosura në L=1.00m'	m'	50.00	2.30	115.00
4	Montimi i profileve metalike vertikale me dim. 20 x 20 x 1.5 mm me gjatësi 1 m' të				

	të vendosura në çdo L=10 cm				
5	Mbyllja e shtyllave metalike nga sipër me dim. 60 x 60 x 3 mm	m'	250.00	0.80	200.00
6	Mbyllja e shtyllave metalike nga sipër me dim. 20 x 20x2 mm	copë	13.00	0.10	1.30
7	Ngjyrosja e tërësishme e rrethojës me dy llyrje : minium dhe dy llyrje ngjyrë	copë	250.00	0.07	17.50
		m'	360.00	1.50	540.00
			Gjithsej:		938.80
			tvsh 18%		168.98
			Totali		1,107.78

5. Rrethoja ne shkollen "Ali Hadri"-Peran

Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	ç.njës.	Shuma
1	Gërmimi në tokë të kategorisë së IV-të dhe V-të për vendosjen e themeleve të veçuara me dim. 50x50x80 cm x cm x cm Në llogari hyjnë edhe rrafshimi i llorenit	m ³	4.80	2.00	9.60
2	Furnizimi me material dhe vendosja e zhavorit Fr 0-60 mm. Trashësia e shtresës së zhavorit duhet të jetë 10 cm. Në pozicion të përshkruar edhe ngjeshja e zhavorit të vendosur.	m ³	0.30	4.50	1.35
3	Furnizimi me material dhe vendosja e zhavorit Fr 0-31.5 mm. Trashësia e shtresës së zhavorit duhet të jetë 10 cm. Në pozicion të përshkruar edhe ngjeshja e zhavorit të vendosur.	m ³	0.33	4.50	1.46
4	Betonimi i themeleve me dim. 50x50x60 cm x cm x cm me beton M30, duke patur kujdes që të bëhet ankerimi i shtyllave metalike 60 x 60 x 3 mm të cilat futen në masë betoni min. 50 cm në llogari hyjnë edhe armimi sipas detajit të paraqitur nga ar. mbikq.	m ³	1.95	45.00	87.75
5	Montimi i shtyllave metalike me dim. 60 x 60 x 3 mm me gjatësi 2.00 m' të vendosura në çdo L=2.06 m'	copë	13.00	6.30	81.90
6	Montimi i profileve metalike horiz. me dim. 40 x 40 x 2 mm me gjatësi 2.00 m' të vendosura në L=1.00 m'	m'	48.00	2.30	110.40
7	Montimi i profileve metalike vertikale me dim. 20 x 20 x 2 mm me gjatësi 1.50 m' të vendosura në çdo L=10 cm	m'	360.00	0.80	288.00
8	Furnizimi dhe montimi i derës njëkajore me rrota rreshqitëse të vendosura paraqitëse të bazën e betonit dhe që duhet të ketë dyfishin e gjatësisë së derës (L= 9 m) dera e hyrjes duhet të jetë me gjatësi b=4.5 m dhe lartësi të njëjtë me rrethojën. Dera duhet të fiksohet në shtyllat e rrethojës, me të gjitha elementet e tjera përcjellëse që parashihen për dyer : dorëzën, cilindrat, qelësat, përforcues , shtangues të derës në tokë. Dy shtylla metalike në të cilat përforcohet dera duhet të kenë dimensione: 100*60*3mm dhe e njëjta me lartësi të rrethojës të fonduara në themelin e betonit h = 50 cm. Korniza e tabeles/ ramit në të kater anet të jetë (40*40*3mm) si dhe shufrat vertikale të vendosen çdo 10 cm (20*20*2 mm) të salduara në kornizën e tabeles metalike .	copë	1.00	190.00	190.00
9	Punimi i derës hyrëse me dim. 1,1 x 1.5 m' me konstrukcion metalik me të gjitha elementet përcjellëse : me kornizë 40x 40 x 3 mm, paneli 20 x 20 x 2 mm	copë	1.00	50.00	50.00
10	Mbyllja e shtyllave metalike nga sipër me dim. 60 x 60 x 3 mm	copë	193	0.10	19.30
11	Mbyllja e shtyllave metalike nga sipër me dim. 20 x 20x2 mm	copë	3,850.00	0.07	269.50
12	Sanimi i profileve metalike vertikale me dim. 20 x 20 x 2 mm me gjatësi 1.50 m' të vendosura në çdo L=10 cm	copë	770.00	1.00	770.00
13	Ngjyrosja e tërësishme e rrethojës me dy llyrje : minium dhe dy llyrje me ngjyrë	m'	24.00	1.60	38.40
			Gjithsej:		1,917.66
			tvsh 18%		345.18
			Totali		2,262.84

7. Rrethoja ne shkollen "Rilindja"-Hërticë

Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	ç.njës.	Shuma
1	Piketimi i perimetrit në të cilën do të rrethohet parcela.	m'	165.00	0.10	16.50
2	Punimi i situacionit dhe profili gjatësor të rrethojës pas perfundimit të punimeve (Situacioni dhe profili gjatësor duhet të punohet pas ekzekutimit të plotë të punëve dhe të bazohet në matje gjeodezike të sakta në terren .) Projekti i realizimit				

3	Pastrimi fitosanitar I terë perimetrit te rrethojës (Pastrimi fitosanitar përfshinë prerjen e shkurrave, barishteve dhe koshjen e barit. Në këtë pozicion duhet të përfshihet edhe krasitja e drunjtve dhe prerja e drunjtve te thatë.)	m'	165.00	0.25	41.25
4	Mbetjet nga pastrimi fitosanitarë nuk lejohet te dëjzen ato duhet te barten ne deponi .	m'	165.00	0.50	82.50
5	Gërmimi në tokë të kategorisë së IV-të dhe V-të për vendosjen e themeleve të veçuara me dim. 50x50x80 cmxcmxcm Në llogari hyjnë edhe rrafshimi i terrenit	Paushall	1.00	50.00	50.00
6	Furnizimi me material dhe vendosja e zhavorit Fr 0-60 mm. Trashësia e shtreses se zhavorit duhet te jetë 10 cm. Në pozicion te përfshihet edhe ngjeshja e zhavorit të vendosur.	m³	15.60	2.00	31.20
7	Furnizimi me material dhe vendosja e zhavorit Fr 0-31.5 mm. Trashësia e shtreses se zhavorit duhet te jetë 10 cm. Në pozicion te përfshihet edhe ngjeshja e zhavorit të vendosur.	m³	1.95	4.50	8.78
8	Betonimi i themeleve me dim.50x50x60 cmxcmxcm me beton MB 30, duke patur kujdes që të bëhet ankerimi i shtyllave metalike 60 x 60 x 3 mm të cilat futen në masë betoni min.50 cm,në llogari hyjnë edhe armimi sipës detailit të paragjitur nga or.mbiq.	m³	3.90	4.50	17.55
9	Montimi i shtyllave metalike me dim. 60 x 60 x 3 mm me gjatësi 2.00 m' të vendosura në çdo L=2.06 m'	m³	11.70	45.00	526.50
10	Montimi i profileve metalike horiz me dim. 40 x 40 x 2 mm me gjatësi 2.00 m' të vendosura në L=1.00 m'	copë	78	6.30	491.40
11	Montimi i profileve metalike vertikale me dim. 20 x 20 x 2 mm me gjatësi 1.50 m' të vendosura në çdo L=10 cm	m'	330.00	2.30	759.00
12	Furnizimi dhe montimi i derës njëkahore me rrota rreshtqëse te vendosura mbi kanalim rreshtqës (të vendosura paraprakisht ne bazën r betonit dhe që duhet te ketë dyfishin e gjatësisë së derës L= 9 m) dera e hyrjes duhet te jetë me gjatësi b=4.5 m dhe lartësi të njëjtë me rrethojën. Dera duhet te fiksohet ne shtyllat e rrethojës, me të gjitha elementet e tjera përcjellëse që parashihen per dyer : dorezën, cilindrat, qëllësat, përforcues , shtangues te derës në tokë. Dy shtylla metalike ne te cilat perforcohet dera duhet te kenë dimensione: 100*60*3mm dhe e njëjta me lartësi te rrethojës te fonduara ne themelin e betonit h = 50 cm. Korniza e tabelës/ramit ne te kater anet te jetë (40*40*3mm) si dhe shufrat vertikale te vendosen çdo 10 cm (20*20*2 mm) te salduara ne kornizen e tabelës metalike .	m'	2,475.00	0.80	1,980.00
13	Punimi i derës hyrse me dim. 1.1 x 1.5 m' me konstrukcion metalik me te gjitha elementet/percjellose : me kornizë 40x 40 x 3 mm, paneli 20 x 20 x 2 mm	copë	2.00	190.00	380.00
14	Mbyllja e shtyllave metalike nga sipër me dim. 60 x 60 x 3mm	copë	1.00	50.00	50.00
15	Mbyllja e shtyllave metalike nga sipër me dim. 20 x 20x2 mm	copë	78	0.10	7.80
16	Ngjyrosja e tërësishtme e rrethojës me dy llyrje : minium dhe dy llyrje me ngjyrë	copë	1650	0.07	115.50
		m'	165	1.60	264.00
			Gjithsej:		4,821.98
			tresh 18%		867.96
			Totali		5,689.93

8. Rrethoja ne shkollen "Afrimi e Fahriu"-Lluzhan

Nr.	Përshkrimi i punëve	Nivëria	Saxia	ç.mësi:	Shuma
1	Gërmimi në tokë të kategorisë së IV-të dhe V-të për vendosjen e themeleve të veçuara me dim. 50x50x80 cmxcmxcm Në llogari hyjnë edhe rrafshimi i terrenit	m³	4.80	2.00	9.60
2	Furnizimi me material dhe vendosja e zhavorit Fr 0-60 mm. Trashësia e shtreses se zhavorit duhet te jetë 10 cm. Në pozicion te përfshihet edhe ngjeshja e zhavorit të vendosur.	m³	0.30	4.50	1.35
3	Furnizimi me material dhe vendosja e zhavorit Fr 0-31.5 mm. Trashësia e shtreses se zhavorit duhet te jetë 10 cm. Në pozicion te përfshihet edhe ngjeshja e zhavorit të vendosur.				

